

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me zyrtarin ligjor Shaban Prekalla, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.K., nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale të vjedhjes së pyllit në vazhdim, nga neni 358 par.2 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, P.nr.35/2018, të dt.11.01.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me 06.02.2019, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, kurse Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, P.nr.35/2018, të dt.11.01.2019, **vërtetohet.**

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, P.nr.35/2018, të dt.11.01.2019, është shpallur fajtor i akuzuari H.K., për shkak të veprës penale të vjedhjes së pyllit në vazhdim, nga neni 358 par.2 të KPK, dhe i është shqiptuar dënim me kusht duke i vërtetuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po qesë i akuzuari në afatin e verifikimit prej 2(dy)viteve, nuk kryen ndonjë vepër të re penale, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 400Euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po qesë i akuzuari në afatin e verifikimit prej 2(dy)viteve nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Është obliguar i akuzuari që në emër të kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarës Komunës së Vushtrrisë-Drejtoria për Zhvillim, Bujqësi dhe Zhvillim Rural-Spektori i Pylltarisë të paguajë shumën e përgjithshme prej 771,12(shtatëqindeshtatëdhjetenjë)Euro e dymbëdhjetë)cent, për kompensimin e dëmit të shkaktuar.

Gjithashtu obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale, sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohen masa më të rrepta.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.104/2019, të datës 31.01.2019, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ka

propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i ashpër.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

### **Ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, nuk është e bazuar**

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se dënimi me kusht sikurse ai me burgim, po ashtu edhe ai me gjobë nuk janë adekuat përgjegjësisë penalo juridike të akuzuarit, sepse gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar vetëm rrethanat lehtësuese nga neni 73 i KPK, duke pasur parasysh se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, rrethanat personale të të njëjtit, përkatësisht se është mbajtës i vetëm i familjes, se është punëtor fizik, si dhe ka premtuar se vepra të tilla penale apo të tjera nuk do të kryej, kurse rrethanat rënduese nuk i ka vlerësuar andaj, edhe vendimi për dënimin e shqiptuar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit nuk janë të drejta.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se është i gjendjes së varfër ekonomike, se i njëjti asnjëherë tjetër nuk ka ra në kundërshtim me ligjin, se është mbajtës i vetëm i familjes, se është punëtor krahu, se është përndarë thellësisht për veprën penale të kryer, kurse sa u përket rrethanave rënduese nuk gjeti, e gjithashtu edhe nga ankesa e Prokurorisë, rrethana posaçërisht rënduese nuk gjeti, andaj, në prani të këtyre rrethanave kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1. nr.83/2019, të datës 06.02.2019**

**Zyrtari ligjor**  
**Shaban Prekalla**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Shqipe Qerimi**